Republika e Kosovës
Republika Kosova - Republic of Kosovo

ZYRA E RREGULLATORIT PËR ENERGJI
REGULATORNI URED ZA ENERGIJU
ENERGY REGULATORY OFFICE

RAPORTI RREGULLATIV

Përcaktimi i të Hyrave Maksimale të Lejuara për Ngrohtoren e Qytetit Termokos SH.A.
Sezoni i Ngrohjes 2026/2027

/Draft për konsultim publik/

Prishtinë, nëntor 2026

Adresa: Rr. Bekim Fehmiu (Ish Ndërtesa e Fazitës), kati:2, 10000 Prishtinë, Kosovë
Tel: 038 247 615 lok. 101, Fax: 038 247 620, E-mail: info@ero-ks.org, web: www.ero-ks.org

PËRMBAJTJA

1. Hyrje 3
2. Parimet dhe Formulimi i Metodologjisë Tarifore 4
3. Përcaktimi i të Hyrave të Lejuara 6
3.1 Vlerësimi dhe përcaktimi i kostove operative të lejuara 7
3.2 Përcaktimi i Bazës së Rregulluar të Aseteve (RAB) 15
3.2.1 Përcaktimi i Bazës së Rregulluar të Aseteve Fillestarë (RABnfill.) 15
3.2.2 Përcaktimi i Investimeve të reja të lejuara 16
3.2.3 Përcaktimi i Kapitalit Punues 24
3.2.4 Zhvlerësimi Vjetorë i Aseteve - realizuar në sezonin 2025/26 (‘n-1’) 24
3.2.5 Tjetërsimet 24
3.3 Vlerësimi dhe Përcaktimi i Zhvlerësimit Vjetor për sezonin 2026/2027 25
3.4 Përcaktimi i Kthimit të Lejuar në RAB (Fitimi i Lejuar) 25
3.4.1 Llogaritja e Normës së Kthimit (RoR) të Lejuar 26
3.5 Përcaktimi i Kostos së Humbjeve në Rrjet 29
3.6 Përshtatja (Axhustimi) 29
3.7 Llogaritja e të Hyrave Maksimale të Lejuara - Përmbledhje 29
4. Bilanci i Energjisë Termike 30

Figurat

Figura 1: Skema e llogaritjes së të hyrave të lejuara 5
Figura 2: Paraqitja skematike e kostove operacionale të propozuara nga NQ Termokos dhe të lejuara nga ZRRE-ja për sezonin e ngrohjes 2026/2027 9

Tabelat

Tabela 1: Kostot e paraqitura nga ana e NQ Termokos SH.A., dhe ato të lejuara nga ZRRE (Në €) 8
Tabela 2: RAB dhe komponentët e tij - NQ TERMOKOS sezoni i ngrohjes 2026/2027 25
Tabela 3: RABf dhe komponentët e tij - NQ TERMOKOS sezoni i ngrohjes 2026/2027 25
Tabela 4: Kthimi i Lejuar (Profiti i Lejuar) në RABf për sezonin e ngrohjes 2026/2027 28
Tabela 5: Të Hyrat e lejuara për NQ Termokos sezoni i ngrohjes 2026/2027 30
Tabela 6: Përmbledhje e Bilancit të energjisë termike 31

1. Hyrje

Në pajtim me legjislacionin primar – nenet 47 dhe 48 të Ligjit për Rregullatorin e Energjisë, Zyra e Rregullatorit për Energji (ZRRE) është përgjegjëse për përcaktimin e metodologjisë së tarifave dhe aprovimin e tarifave në sektorin e rregulluar të energjisë; këtu janë një sërë parimesh të gjera, siç janë parimet e mos-diskriminimit dhe arsyeshmërisë me të cilat ndërmarrjet e energjisë do të mund t'i rikthenin të gjitha kostot e arsyeshme përfshirë edhe kthimin e arsyeshëm në investimet e tyre. Gjithashtu nenet 18 dhe 19 të Ligjit për Energjinë Termike përcaktojnë se Furnizuesi me obligimin e shërbimit publik, kryen furnizimin me energji termike me tarifa të rregulluara.

Përderisa sektori i energjisë termike në transportimin dhe shpërndarjen e energjisë termike klasifikohet si monopol i natyrshëm, dhe për arsye se gjithashtu në gjenerim dhe furnizim ende nuk ekziston konkurrenca, atëherë tarifat e ngrohjes qendrore, që i përmbajnë të gjitha komponentët e lartpërmendura, i nënshtrohen përcaktimit - miratimit nga ZRRE-ja.

Brenda kompetencave dhe obligimeve të veta ligjore, Zyra e Rregullatorit për Energji ka nxjerrë Rregullën për Vendosjen e Çmimeve të Energjisë Termike. Rregulla përcakton procedurat për dorëzimin, shqyrtimin e aplikacionit tarifor dhe aprovimin e tarifave, si dhe Metodologjinë për llogaritjen e të hyrave të lejuara dhe tarifave.

Për përcaktimin e të hyrave të lejuara për sezonin e ngrohjes 2026/2027 janë marrë parasysh si vijon:

- Informatat e dhëna nga NQ Termokosi në aplikacionin e tyre tarifor për sezonin e ngrohjes 2026/2027;
- Informatat e dhëna nga NQ Termokosi gjatë raportimit rregullativ të realizimeve – shpenzimet dhe të ardhurat, asetet / investimet, si dhe informatat teknike dhe për konsumatorë që aktualisht janë realizuar në sezonin e ngrohjes 2025/2026 dhe në sezonet e mëparshme;

<u>Ecuria e procesit të shqyrtimit tarifor:</u>

- **Me 5 qershor 2026** – ZRRE ka lëshuar shkresën për njoftimin e fillimit të shqyrtimit të tarifave për NQ Termokos për sezonin 2025/2026; kjo është pasuar me kërkesën e ZRRE-së për të dhëna dhe informata dërguar me 5 qershor 2026, ku janë përshkruar detajisht të dhënat dhe informatat që NQ Termokos duhet dorëzuar për shqyrtimin tarifor, si dhe Planin dhe Orarin;
- **Me 14 korrik 2026** – NQ Termokos përmes e-mailit ka dorëzuar aplikacionin tarifor për sezonin 2026/2027 me të dhënat dhe informatat e kërkuara për shqyrtim tarifor;
- **Me 17 shtator 2026 –** Pas analizimit dhe vlerësimit të të dhënave dhe informatave të dorëzuara nga NQ Termokos, ZRRE ka dërguar komentet me shkrim, ku janë specifikuar kërkesat për korrigjim, përmirësim dhe plotësim të aplikacionit fillestarë;
- **Me 2 tetor 2026** – NQ Termokos ka ri-dorëzuar aplikacionin me disa nga korrigjimet, përmirësimet dhe plotësimet e kërkuara në komentet e ZRRE-së, si dhe përgjigjet në komentet e ZRRE-së.

2. Parimet dhe Formulimi i Metodologjisë Tarifore

Për përcaktimin e të Hyrave të lejuara dhe të tarifave të energjisë termike për sezonin 2026/2027 është zbatuar Metodologjia e përcaktuar në Rregullën për Vendosjen e Çmimeve të Energjisë Termike.

Parimet

Parim bazë i kësaj metodologjie është se tarifat për ndërmarrjet që ofrojnë shërbime publike duhet të mbulojnë të gjitha kostot e arsyeshme - operative dhe kapitale, kështu që në njërën anë konsumatorët nuk do të duhej të paguajnë më tepër se sa kostoja e shkaktuar për ofrimin e shërbimeve, ndërsa në anën tjetër ndërmarrja e shërbimeve publike duhet te mbulojë të gjitha kostot e arsyetuara plus një normë të arsyeshme të kthimit në investimet kapitale. Çmimi final i shërbimit zakonisht përcaktohet për të përfshirë të gjitha kostot operative të ndërmarrjeve që ofrojnë shërbime publike, d.m.th., të mbulojë koston e prodhimit, shpërndarjes dhe furnizimit (operimi dhe mirëmbajtja, lënda djegëse, pagat, kostot e humbjeve në rrjet, shpenzimet e përbashkëta dhe administrative, etj.) plus një kthim të arsyeshëm në investimet që janë dedikuar ofrimit të shërbimit publik.

Duke qenë se në disa raste rregullimi i tillë nuk nxit ndërmarrjet për të ngritur efikasitetin operativ dhe të stimuloj kursimin e shpenzimeve, përkundrazi mund të nxisin mbi-investime në asete dhe gjithashtu, dhe duke marrë parasysh obligimin e Rregullatorit për të mbrojtur konsumatorët, kërkohet që ndërmarrjet jo vetëm të dëshmojnë " shpenzimet e arsyeshme" të deklaruara, por edhe të tregojnë një rritje te efikasitetit operativ dhe të kostove. Masat e tilla krijojnë bazë për bashkërendimin në fillim të shqyrtimit tarifor, në të cilën Rregullatori shpërblen apo ndëshkon ndërmarrjen për rritjen apo rënien e efikasitetit dhe kontrollit të kostos.

Formulimi

Me qëllim të llogaritjes së të Hyrave të lejuara dhe llogaritjes përfundimtare të tarifave, në Rregullën për Vendosjen e Çmimeve të Energjisë Termike (shtojcat 1,2,3, dhe 6) është dhënë në detaje formulimi i Metodologjisë tarifore. Megjithatë, për arsye konsistence, formulimi do të paraqitet shkurtimisht edhe në këtë raport.

Skematikisht, Metodologjia tarifore mund të tregohet si më poshtë. Kostot të cilat ndërmarrja duhet t'i mbulojë përbëhen nga kostot operative, nga zhvlerësimi që paraqet mundësinë që ndërmarrja të zëvendësoj asetet e veta, koston e humbjeve të rrjetit dhe kthimin në Bazën e Rregulluar të Aseteve (RAB), e cila në fakt paraqet fitimin për ndërmarrjen.



Figura 1: Skema e llogaritjes së të hyrave të lejuara

Formulat bazë të rregullimit:

Të hyrat e lejuara janë llogaritur sipas formulës:
MAR = OPM + DEP + RTN + LOS + ADJ

Ku:

MAR Të Hyrat e lejuara maksimale;
OPM Kostot e lejuara të operimit dhe mirëmbajtjes;
DEP Zhvlerësimi vjetor i lejuar;
RTN Kthimi i lejuar në asete;
LOS Kostoja e humbjeve në rrjet;
ADJ Përshtatja (axhustimi) i të hyrave.

Të Hyrat e lejuara paraqesin koston vjetore të kompanisë, e që përmbajnë: i) kostot operative, të cilat janë të "arsyetuara"; ii) zhvlerësimin vjetor; iii) Koston e humbjeve në rrjet; dhe iv) kthimin e lejuar në Bazën e Rregulluar të Aseteve (RAB).

Kostot operative përbehen nga pjesa fikse dhe ajo variabile, e formuluar si vijon:

$$OC = OC_F + OC_v$$

Kostot operative paraqesin kostot totale të arsyeshme të parashikuara për një vit, e që këtu hyjnë: i) kostot për lëndë djegëse, kostot e blerjes së energjisë termike dhe kostot tjera si energjia elektrike, kemikalet për trajtimin e ujit, pjesët rezervë; ii) kostot tjera operative të sistemit, riparimet dhe mirëmbajtja; dhe iii) kostot e personelit dhe kostot e përbashkëta. Kostot operative të lejuara nuk përfshijnë: i) subvencionet; ii) kostot e refuzuara nga autoritetet tatimore, dhe kostot e ndarjes së rezervave apo shpërndarjes së tyre; dhe iii) pagesat e qirasë për mjetet që nuk janë të shënuara në llogari-mbajtjen, shpenzimet financiare apo shpenzimet tjera te pa arsyetuara.

Baza e Rregulluar e Aseteve është llogaritur sipas formulës:

$$\mathbf{RAB_n^{përf.} = RAB_n^{fill.} + INV_n + WC_n – DEP_{n-1} – DIS_{n-1}}$$

Baza e Rregulluar e Aseteve (RAB) paraqet asetet e ndërmarrjes të konsideruara për përdorim dhe të dobishme për ofrimin e shërbimit publik, e të cilat përfshijnë:

i) Bazën e Rregulluar të Asteve fillestar ($RAB_n^{fill.}$) që faktikisht paraqet RAB-in përfundimtarë të realizuar në sezonin paraprak 2025/26 (n-1);
ii) Investimet e reja kur janë të planifikuara dhe të aprovuara nga Rregullatori (INV_n);
iii) Kapitali i mjaftueshëm punues për kompaninë që të kryejë aktivitetet e saj (WC_n); Zhvlerësimin e aseteve të realizuar në sezonin paraprak 2025/26 (n-1) (DEP_{n-1}) dhe
iv) Asetet e tjetërsuara (DIS_{n-1}) .

ZRRE-ja, si Normë të Kthimit, ka marrë vlerën e WACC-ut (Mesatares së ponderuar të kostos së kapitalit). WACC (%) është shuma e mesatares së ponderuar të kostos së ekuitetit dhe kostos së borxhit, dhe është llogaritur sipas formulës:

$$\mathbf{WACC = [(D/V) * k_d] + [(E/V) * k_e]}$$

Ku:

D/V-	Pjesa e borxhit nga baza totale e kapitalit
E/V -	Pjesa e ekuitetit nga baza totale e kapitalit
V -	Baza totale e kapitalit, e cila është i gjithë ekuiteti dhe borxhi
$\mathbf{k_d}$ -	Kostoja e borxhit
$\mathbf{k_e}$ -	Kostoja e ekuitetit

3. Përcaktimi i të Hyrave të Lejuara

Për përcaktimin e të Hyrave të lejuara të NQ Termokos SH.A. për sezonin 2026/2027, në pajtim Rregullën për Vendosjen e Çmimeve të Energjisë Termike, ZRRE ka ndërmarrë si vijon:

1) Vlerësimin dhe përcaktimin e kostove operative të lejuara;
2) Vlerësimin dhe përcaktimin e zhvlerësimit;
3) Përcaktimin e Kthimit të lejuar në RAB (kthimit në investime), i cili përfshin:
   a) përcaktimin e RAB-it – vlerësimi dhe aprovimi i aseteve të kompanisë, verifikimi dhe aprovimi i investimeve të planifikuara dhe kapitalit punues; dhe
   b) llogaritjen e Normës së kthimit të lejuar (RoR)/ WACC;
4) Vlerësimin dhe përcaktimin e kostos së lejuar për humbjet në rrjet.

Në përcaktimin e të Hyrave të lejuara, ZRRE ka marrë parasysh sa vijon:

- Informatat e ofruara nga NQ Termokosi në aplikacionin e tij për tarifat për sezonin e ngrohjes 2026/2027 – të dhënat rreth të ardhurave të parashikuara nga shitja e ngrohjes dhe nga shërbimet e tjera të ndërlidhura, kostot e parashikuara totale, asetet dhe investimet e planifikuara, prodhimin dhe furnizimin e parashikuar të ngrohjes, si dhe sipërfaqen ngrohëse të parashikuar;
- Informatat e ofruara nga NQ Termokosi gjatë raportimit rregullativ – shpenzimet dhe të ardhurat, asetet/ investimet, si edhe informatat teknike dhe për konsumatorë të cilat faktikisht janë realizuar në sezonin e kaluar 2025/2026;

- Informatat që ZRRE i ka siguruar nga shqyrtimet tarifore dhe monitorimet e realizimeve dhe performancës të sezoneve / viteve të kaluara.

Duke e ditur se informatat e parashikuara janë thelbësore për përcaktimin e të Hyrave të lejuara, këto do të duhej të ishin të besueshme dhe reale. Përgjithësisht, në parashikimin / planifikimin e biznesit do të duhej të aplikohet qasje reale e përcjellur me vlerësim të hollësishëm të faktorëve të shumtë që ndikojnë në biznes; p.sh., vlerësimi i tregut dhe parashikimi i zgjerimit të bazës së konsumatorëve, vlerësimi i prodhimit / mundësitë e furnizimit dhe mundësitë financiare të kompanisë. Natyrisht, parashikimi/planifikimi i drejtë duhet të bazohet në të dhënat që kompania i ka realizuar në të kaluarën gjatë një periudhe të caktuar.

Duhet cekur këtu se, aplikacioni për tarifa i NQ Termokos ka qenë gjer në një masë i detajuar dhe i kompletuar. Vërejtja kryesore ka të bëj me të dhënat e ndërlidhura me matjen e ngrohjes në nivel apartamenti në ndërtesat kolektive në kuadër të projektit MCC – 'Prishtina Heat Save', të cilat janë dërguar me vonesë dhe kanë qenë jo të plota, të paqarta dhe me mjaft gabime e pasaktësi. Gjithashtu edhe në disa nga të dhënat dhe informatat që ka përmbajtur aplikacioni janë vërejtur pasaktësi, mos-përputhje dhe jo-konsistencë, të cilat, me disa përjashtime, janë përmirësuar sqaruar dhe plotësuar pas komenteve të ZRRE-së dhe takimeve të përbashkëta ZRRE-NQ Termokos.

Në fakt, sa i përket informatave të parashikuara (siç është përcaktuar në Shtojcën 4 të Rregullës për Vendosjen e Çmimeve të Energjisë Termike, NQ Termokosi i ka dorëzuar ZRRE-së pasqyrat/tabelat që përshijnë të ardhurat dhe kostot e parashikuara, të dhëna teknike dhe të konsumatorëve, asetet operative dhe investimet e parashikuara, për periudhën një vjeçare që mbulon plotësisht sezonin e ngrohjes – periudha: 15 tetor 2026 – 14 tetor 2027. Ndërsa si dokumente mbështetëse ka dorëzuar: i) Raportin e auditorit dhe Pasqyrat financiare statusore për vitin 2025; ii) Matjet e konsumit të regjistruara në sezonin e kaluar sipas Listës së nënstacioneve - të dhënat për sipërfaqet ngrohëse dhe kapacitetet përkatëse, si dhe të dhënat tjera teknike; ii) Listën e aseteve – të dhënat detale për asetet fikse ku janë dhënë vlera fillestare (e blerjes), zhvlerësimi i akumuluar dhe vlera e tanishme e aseteve (e dorëzuar në raportimet e rregullta vjetore/sezonale); iii) Planifikimet e Investimeve në periudhën njëvjeçare që përfshinë sezonin 2026/27; iv) Planifikimet për kyçjet e reja për sezonin 2026/2027; v) Planifikimet për sipërfaqen ngrohëse të konsumatorëve në sezonin 2026/'27; dhe vi) Matjet e regjistruara për energjinë termike të prodhuar nga ko-gjenerimi (dorëzuar në raportimet e rregullta vjetore/sezonale);

Pavarësisht që NQ Termokos ka dërguar të dhëna dhe informata jo të plota për përcaktimin e të Hyrave të lejuara për sezonin 2026/2027, ZRRE-ja ka bërë përpjekje dhe ka angazhuar ekspertizën në dispozicion për të bërë një vlerësim sa më real të informatave të parashikuara të dorëzuara nga ana e Termokosit. Është bërë një analizë gjithëpërfshirëse dhe vlerësim i informatave të paraqitura, që është përcjellur me krahasimin e të dhënave respektive nga sezonet e kaluara, me qëllim që të bëhet përcaktimi (parashikimi) i saktë i të hyrave të lejuara për këtë sezon.

3.1 Vlerësimi dhe përcaktimi i kostove operative të lejuara

Planifikimet për kostot operative janë dorëzuar nga NQ Termokos për periudhën 15 tetor 2026 – 14 tetor 2027, periudhë kjo që mbulon gjithë sezonin e ngrohjes 2026/2027. Këto kosto janë strukturuar si kosto variabël dhe fikse, e cila ndarje kryesisht është në pajtim me dispozitat e Rregullës për Vendosjen e Çmimeve të Energjisë Termike, si dhe me parimet e avancuara të kontabilitetit dhe me Standardet Kosovare të Kontabilitetit.

Në këtë seksion do të tregohen në mënyrë tabelare shpenzimet e parashikuara siç janë prezantuar nga NQ Termokosi dhe shpenzimet operative të lejuara që ZRRE i ka aprovuar (Tabela 1.) Në vijim të tabelës është dhënë shpjegimi analitik për secilin pozicion të kostove operative.

Tabela 1: Kostot e paraqitura nga ana e NQ Termokos, dhe ato të lejuara nga ZRRE (Në €)

KOSTOT OPERATIVE – NQ Termokos sezoni 2026/2027			
	KOSTOT E PROPOZUARA		KOSTOT E LEJUARA NGA ZRRE
	10,021,769 €		7,700,152 €
Nr.	**Kategoritë e kostove**	**Propozuar nga NQ Termokos (€)**	**Lejuar nga ZRRE (€)**
	KOSTOT VARIABILE		
1	Gjenerimi vetanak	528	528
2	Blerjet e energjisë nga kogjenerimi – komponenta variabile	588,253	543,644
3	Kemikaljet për trajtimin e ujit	14,932	14,932
4	Uji	89,676	89,676
5	Energjia elektrike (prodhimi dhe nënstacionet e distr.)	1,571,975	1,429,050
6	Kostot e personelit (puna direkte)	1,949,495	1,587,244
7	Taksa vjetore e licencave	-	-
8	Borxhi i keq i lejuar	818,541	530,001
9	Të tjera variabile	-	-
	TOTALI I KOSTOVE VARIABILE	**5,033,399**	**4,195,074**
	KOSTOT FIKSE		
11	Materialet dhe shërbimet	61,000	61,000
12	Riparimet dhe mirëmbajtja	154,900	154,900
13	Blerjet e energjisë nga kogjenerimi – komponenta fikse	1,275,687	1,178,947
14	Shpenzimet për administratë	256,620	256,620
15	Shpenzimet e personelit (përveç punës direkte)	2,179,108	1,407,556
16	Kostot e shitjes dhe të tjera administrative	1,061,055	446,055
	TOTALI I KOSTOVE FIKSE	**4,988,370**	**3,505,078**
	TOTALI I KOSTOVE OPERATIVE	**10,021,769**	**7,700,152**





Figura 2: Paraqitja skematike e kostove operacionale të propozuara nga NQ Termokos dhe të lejuara nga ZRRE-ja për sezonin e ngrohjes 2026/2027

Detajet e kostove kryesore janë paraqitur grafikisht në vijim:



Shpjegim analitik

Në vijim janë dhënë shpjegime të detajuara dhe arsyetimet për përcaktimin / lejimin për secilin grup të kostove respektivisht për pozicionet kryesore të kostove operative.

Kostot variabile:

- **Kostoja e blerjes së energjisë termike nga ko-gjenerimi në TC Kosova B – komponenti i pagesës për sasinë e energjisë termike**:

  - NQ Termokos, në pasqyrën 'B', ka propozuar koston totale të blerjes së energjisë termike nga ko-gjenerimi në vlerë prej 1,863,940 €. Detajet për llogaritjen e kësaj kostoje janë dhënë në dokumentin shpjegues, bazuar në planifikimet: kapacitetin e rezervuar elektrik prej 61,419.7 MWh_{EL}/h dhe sasinë e planifikuar të energjisë termike prej 402,913 MWh_{TH}, si dhe në çmimet përkatëse për kapacitet dhe sasi të energjisë termike të llogaritura sipas marrëveshjes aktuale për shit-blerjen e energjisë termike KEK Gjenerimi – NQ Termokos.
    Megjithatë ZRRE ka bërë ndarjet në pjesën variabile dhe fikse të kësaj kostoje siç paraqitet detajisht në vijim të këtij raporti.

    Më konkretisht, Komponenti variabil i pagesës për sasinë e energjisë termike është bazuar në sasinë e planifikuar dhe çmimin prej 1.36 €/MWh_{TH}.

  - Vlerësimi – Lidhur me planifikimin e kapacitetit të rezervuar dhe sasisë së energjisë termike fillimisht duhet theksuar se planifikimi nuk ka marrë për bazë efiçiencën e energjisë gjegjësisht kursimin e energjisë që pritet si rrjedhojë e vazhdimit të implementimit të matjes së konsumit dhe faturimit të bazuar në matje. Lidhur me këtë duhet theksuar se, në Bilancin afatgjatë të energjisë termike të miratuar nga ZRRE është marrë në konsideratë efiçienca e energjisë gjegjësisht kursimi i energjisë termike për ngrohje. Rrjedhimisht ZRRE në komentet me shkrim ka kërkuar që në planifikimet e shqyrtimit tarifor të merret parasysh projeksionet e bilancit afatgjatë. Megjithatë NQ Termokos ka qëndruar pranë planifikimeve fillestare, duke dhënë disa arsyetime të përgjithshme, por që nuk kanë adresuar çështjen e projeksioneve të bilancit afatgjatë. Prandaj ZRRE për të lejuar kapacitetin e rezervuar elektrik dhe sasinë e energjisë termike ju ka referuar projeksioneve të Bilancit afatgjatë për sezonin 2026/'27. Rrjedhimisht ka përvetësuar sasinë e energjisë termike prej 372,359 MWh_{TH}, dhe ka llogaritur koston për sasinë e energjisë termike. Duhet theksuar gjithashtu se është përfshirë edhe komponenta e pagesës për taksën vjetore të licencimit, e cila llogaritet bazuar në taksën vjetore të licencave për prodhimin e energjisë termike të përcaktuar sipas Rregullës për Taksat të nxjerrë nga ZRRE.
    Bazuar në sa u tha më lartë llogaritjet rezultojnë si në vijim:
    - Komponenti i pagesës për sasinë e energjisë termike: 506,408 €; dhe
    - Komponenti i pagesës për taksën vjetore të licencimit: 37,236 €.

    Komponentët e lartë-përshkruar rezultojnë komponentën e pagesës për sasinë e energjisë termike nga ko-gjenerimi në TC Kosova B, në vlerë prej **543,644 €** e cila lejohet për sezonin 2026/2027.

  - Është e vlefshme të përmendet se kostoja e tërësishme e blerjes së energjisë termike nga ko-gjenerimi në TC Kosova B – që përshinë komponentën për kapacitetin e rezervuar elektrik dhe komponentën për sasinë e energjisë termike – është **1,722,590 €**.

- **Kostoja e lëndës djegëse – mazutit:**

  - NQ Termokos nuk ka propozuar koston e mazutit për shkak se, nga ekipi i ekspertëve ka konstatuar se kaldajat ekzistuese kanë pësuar dëmtime të rënda strukturale mekanike dhe ndërtimore, ashtu si dhe instalimet përkatëse elektrike, kështu që është vlerësuar se operimi i tyre i sigurt dhe efikas është i pamundur. Gjithashtu edhe rezervuarët e mazutit janë dëmtuar kryesisht nga korrozioni dhe stacioni i mazutit është ç'montuar për shkak të ndërtimit të objektit të ri të administratës. NQ Termokos ka planifikuar që gjatë muajit tetor 2026 të punohet në Ngrohtoren e QKUK-së, me ç'rast parashihet të shpenzohen 4.4 ton naftë për prodhimin e 41.35 MWh energji termike. Si rrjedhojë, është planifikuar edhe furnizimi shtesë me 0.5 ton naftë.
  - Vlerësimi - Ky planifikim është bërë duke marrë parasysh përvojën e sezonit të kaluar, kur sezoni ngrohës kishte filluar tetë ditë më herët se zakonisht, për shkak të temperaturave më të ulëta, me ç'rast ishin shfrytëzuar rreth 67 MWh_{TH} energji termike e prodhuar nga nafta. Për këtë arsye NQ Termokos për sezonin 2026/2027 është planifikuar sasia e lartcekur e naftës, me qëllim të sigurimit të furnizimit me ngrohje gjatë muajit tetor. Rrjedhimisht ZRRE lejon koston prej 528€ për naftën shtesë për prodhimin e 41.3 $MWh_{TH.}$

- **Kostoja e ujit për (ri)mbushjen e sistemit të ngrohjes**:

  - NQ Termokos ka propozuar koston në vlerë prej 89,676 €, për sasinë e parashikuar të shpenzimit të ujit për rimbushje të sistemit të shpërndarjes (rrjetit primarë) dhe për nënstacione termike.
  - Vlerësimi – ZRRE ka kryer vlerësimet duke u bazuar në realizimin e kësaj kostoje në sezonet e kaluara, e gjithashtu vlerësimet kanë marrë për bazë sasinë e parashikuar të ujit për rimbushje të rrjetit primar të shpërndarjes dhe të nënstacioneve dhe zvogëlimin e humbjeve sasiore të ujit (në m^3) për shkak të realizimit të projekteve për rehabilitim të rrjetit dhe nënstacioneve. Në këtë kuptim ZRRE pranon koston e propozuar të ujit prej **89,676 €**.

- **Kostoja e kemikaljeve për trajtimin e ujit**

  - NQ Termokosi ka propozuar koston e kemikaljeve për trajtimin e ujit në vlerë prej 14,932 €, Shtimi i kësaj kostoje është i ndërlidhur me projektin aktual të KfW që përmban edhe impiantin e trajtimit kimik të ujit.

  - Vlerësimi – Duke marrë parasysh sasinë e ujit që duhet trajtuar, rrjedhjet e ujit (humbjet) dhe sidomos nevojat për këto kemikalje për zbutjen e ujit në impiantin e ri që është në implementim, ZRRE pranon vlerën e propozuar prej **14,932 €**.

- **Kostoja e energjisë elektrike**

  - Për koston e energjisë elektrike, NQ Termokos ka propozuar vlerën totale prej 1,571,975 €, e cila përfshin konsumin e energjisë elektrike në impiantet e sistemit të prodhimit dhe në nënstacione. Nga kjo shumë, 1,178,780 € janë alokuar për procesin e prodhimit të energjisë termike, ndërsa 393,195 € për konsumin e energjisë elektrike në nënstacione. Në përgjigje të komenteve tona me shkrim për shpjegime dhe detajizime të rritjes së kësaj kostoje për 20%, NQ Termokos ka dhënë konsumin total të energjisë elektrike prej 9,527 MWh_{EL} dhe çmimin mesatarë 165 €/MWh të vlerësuar për sezonin ngrohës 2026/2027.

- Vlerësimi:
  Lidhur me këtë, ZRRE ka analizuar të dhënat e dërguara dhe ka bërë vlerësimet për çmimet duke u bazuar edhe në të dhënat e realizuara të periudhës një vjeçare që përfshinë sezonin 2025/'26. Për sasinë e shpenzuar të energjisë elektrike prej 9,073 MWh kostoja totale ka qenë 1,313,559 €. Nga kjo ne kemi llogaritur çmimin mesatar të realizuar në atë periudhë prej 144.78 €/MWh.
  Fillimisht duhet theksuar se konsumi i planifikuar i energjisë elektrike është për këtë sezonë ka marrë parasysh një rritje pre 5%; duke e vlerësuar si planifikim real është përcaktuar sasia prej 9,526.65 MWh. Ndërsa sa i përket parashikimit të çmimit ZRRE ka bërë vlerësimet duke u bazuar edhe në të dhënat e furnizuesit komercial KEK-u për vitin 2026, si dhe trendëve të çmimeve në tregun e lirë dhe ka fiksuar çmimin mesatarë për tërë periudhë prej 150 €/MWh.. Nga sa u përshkrua më lartë ZRRE ka llogaritur kostoja e energjisë elektrike prej **1,429,050 €** duke u bazuar në sasinë e planifikuar 9,526.65 MWh_{EL} dhe çmimin mesatar 150 €/MWh.**,** e cila lejohet për sezonin 2026/'27. Realizimi i kësaj kostoje (ashtu si edhe të gjitha kostove tjera) do të monitorohet dhe çdo shmangie nga planifikimet do të korrigjohet (axhustohet) në shqyrtimin e ardhshëm tarifor.

- **Kostoja e Personelit ("puna direkte")**

  - NQ Termokos ka paraqitur koston e personelit – "puna direkte", në vlerë mjaft të madhe prej 1,949,495 €. Lidhur me këtë kosto, fillimisht duhet përmendur se gjatë monitorimit të realizimeve të sezoneve të kaluara është konstatuar mbi-realizim i konsiderueshëm i kësaj kostoje në raport me lejimet përkatëse, që përsëritet vazhdimisht nga sezoni në sezonë. Konkretisht në sezonin e kaluar 2025/2026 kostoja e personelit të angazhuar direkt në prodhim dhe shpërndarje është mbi-realizuar për rreth 62%. Njëjtë është vërejtur mbi-planifikim në parashikimet për sezonin 2026/'27, dhe për këtë ZRRE-ja ka kërkuar shpjegime dhe detajim shtesë. Në përgjigjen e tyre, NQ Termokos ka dhënë një shpjegim të shkurtër dhe disa detajime për numrin total e të punësuarve ("260 të punësuar"), pagën mesatare 817 €/muaj, kontributin pensional të pagueshëm nga ndërmarrja 155,000 €, tatimin në paga 208,440€ dhe sigurimin shëndetësor 82,320€.

  - Vlerësimi – ZRRE vlerëson se propozimi i kësaj kostoje është i shoqëruar me pak detaje dhe shpjegime përkatëse, megjithatë nga të dhënat e lartë-përshkruara, ZRRE ka llogaritur koston totale të personeli në vlerë prej 2,994,800€. Duke marre proporcionin e zakonshëm në shqyrtimet e kaluara tarifore, është llogaritu **kostoja e personelit 'puna direkte'** në shumën **1,587,244€**, të cilën e lejon për periudhën e shqyrtimit tarifor 2026/'27.

- **Kostot tjera Variabile, Kostoja e Borxheve të këqija dhe taksa vjetore e licencimit**

  - Në aplikacionin fillestarë, nën kategorinë e kostove tjera variabile NQ Termokos ka paraqitur shumën prej 818,541 € për koston e 'shpenzimit të provizionimit të llogarive të arkëtueshme'. Në komentet tona ne kemi theksuar se, në pajtim me dispozitat e Rregullës për Vendosjen e Çmimeve të Energjisë Termike, llogaritë e arkëtueshme gjegjësisht mos-pagesat trajtohen përmes borxhit të keq i cili llogarit maksimalisht 5% i të hyrave të realizuara në sezonin paraprak. Megjithatë NQ Termokos ka mbetur pranë planifikimit fillestarë për këtë pozicion.

  - Vlerësimi - Për të adresuar qështjen e llogarive të arkëtueshme dhe mos-pagesës, , ZRRE lejon koston e borxhit të keq, e cila llogaritet si përqindje e arsyeshme në të hyrat e ndërmarrjes (d.m.th. vlerën e faturimit nga shitja e ngrohjes). Kjo 'përqindje e arsyeshme' duhet të caktohet në atë mënyrë që të nxis ndërmarrjen për të shtuar përpjekjet për rritjen e nivelit të arkëtimit

të pagesave nga konsumatorët, por njëkohësisht merr parasysh se një shumë e konsiderueshme objektivisht nuk mund të arkëtohet, pra do të mbetet si borxh që faktikisht nuk do të realizohet. Nga sa u tha më lartë ZRRE mendon se niveli i borxhit të keq prej 5% është i arsyeshëm, dhe rrjedhimisht e lejon **koston e borxhit të keq** në vlerën prej **530,001 €**.
Sa i përket taksës së licencimit duhet theksuar se për shkak se nuk parashihet prodhim i energjisë termike nga stabilimentet me mazut të ngrohtores, atëherë ndërmarrja nuk ngarkohet me këtë taksë.

Nga më lartë rezulton se **Kostot Variabile të pranuara** nga ZRRE-ja janë përcaktuar në vlerën **4,195,074€.**

Kostot fikse

- **Kostoja: Riparimet dhe Mirëmbajtja;**

  - NQ Termokos për koston e riparimeve dhe mirëmbajtjes ka planifikuar vlerën prej 154,900 € - kjo paraqet një rritje prej afërsisht 64% krahasuar me realizimin e kësaj kostoje në periudhën e kaluar (94,486 €). Për këtë rritje NQ Termokos ka dhënë arsyetimin për rritjen e punëve të mirëmbajtjes dhe riparimeve si pasoj e zgjerimit të rrjetit.

  - Vlerësimi – Duke marrë parasysh arsyetimin e cekur më lartë, si dhe nevojën për të siguruar operim të qëndrueshëm të stabilimenteve, pajisjeve dhe rrjetit që mundëson një furnizim cilësor, ZRRE e pranon **koston e riparimeve dhe mirëmbajtjes** në vlerën e paraqitur prej **154,900 €.**

- **Kostoja: Materialet dhe Shërbimet:**

  - Për këtë pozicion nga NQ Termokos është propozuar një vlerë më e vogël prej 61,000 €;

  - Vlerësimi – Duke marrë parasysh se kjo kosto është ngushtë e ndërlidhur me koston e riparimeve dhe mirëmbajtjes, vlerësohet se vlera e propozuar nga NQ Termokos është reale dhe rrjedhimisht ZRRE lejon koston **'Materialet dhe Shërbimet'** në vlerë prej **61,000 €.**

- **Kostoja e blerjes së energjisë termike nga ko-gjenerimi në TC Kosova B – komponenti fiks i pagesës për kapacitetin e rezervuar**

  - Komponenti i pagesës për kapacitet të rezervuar e propozuar nga NQ Termokos ka është bazuar në kapacitetin e rezervuar elektrik: 61,420 MWh_{EL}/h dhe çmimin respektiv: 20.77€/MWh_{EL}/h, i cili është çmimi aktual për kapacitetit e rezervuar elektrik sipas marrëveshjes për furnizim me energji termike KEK-Termokos;

  - Vlerësimi – ZRRE konsideron se vlera e parashikuar nga NQ Termokos për kapacitetin e rezervuar është e lartë, rreth 15% më e lartë se realizimi i sezonit të kaluar (53,677 MWh_{EL}/h); për më tepër kjo përqindje e rritjes nuk korrespondon me rritjen e planifikuar të sipërfaqes ngrohëse që është 3.9% që e determinon konsumin e ngrohjes. Gjithashtu planifikimi i kapacitetit elektrik nuk përputhet me të njëjtin planifikim në Bilancin afatgjatë – në fakt për sezonën 2026/'27 në Bilancin afatgjatë është planifikuar kapaciteti prej 56,762 MWh_{EL}/h, i cili është 5.75% më i lartë se realizimi i sezonit kaluar. ZRRE konsideron se kjo rritje është e mjaftueshme për të siguruar prodhim dhe furnizim të qëndrueshëm me energji termike

(ngrohje); për këtë arsye, ZRRE vlerëson se kapaciteti i rezervuar duhet të jetë 56,762 MWh_{EL}/h, dhe, bazuar në këtë vlerësim, pranon si kosto të lejuar shumën prej **1,178,947 €.**

- **Kostot Administrative:**

  - NQ Termokos ka propozuar koston për administratë në vlerë prej 256,620 € duke ofruar detajimet përkatëse, ku përfshihen elementet e zakonshme që përmbajnë kostot administrative.

  - Vlerësimi – Bazuar në sa u përmend më lartë dhe për të lejuar përmirësimin e shërbimeve të ndërmarrjes e veçanërisht shërbimin për konsumatorë, ZRRE vendos të pranoj koston e propozuar në vlerën **256,620€.**

- **Kostoja e Personelit ('e ndryshme prej punës direkte')**

  - NQ Termokos ka paraqitur koston e personelit – "puna jo-direkte", në vlerë mjaft të madhe prej 2,179,108 €. Lidhur me këtë kosto, fillimisht duhet përmendur se gjatë monitorimit të realizimeve të sezoneve të kaluara është konstatuar mbi-realizim i konsiderueshëm i kësaj kostoje në raport me lejimet përkatëse, që përsëritet vazhdimisht nga sezoni në sezonë. Konkretisht për koston e personelit në administratë dhe shërbimet tjera është paraqitur vlera e planifikuar prej 2,179,108 €, që paraqet një rritje prej mbi 15% nga vlera e realizuar në sezonin e kaluar 2025/'26. Njëjtë është vërejtur mbi-planifikim në parashikimet për sezonin 2026/'27, dhe për këtë ZRRE-ja ka kërkuar shpjegime dhe detajim shtesë. Në përgjigjen e tyre, NQ Termokso ka dhënë një shpjegim të shkurtër dhe disa detajime për numrin total e të punësuarve ("260 të punësuar"), pagën mesatare 817 €/muaj, kontributin pensional të pagueshëm nga ndërmarrja 155,000 €, tatimin në paga 208,440€ dhe sigurimin shëndetësor 82,320€.

  - Vlerësimi – ZRRE vlerëson se propozimi i kësaj kostoje është i shoqëruar me pak detaje dhe shpjegime përkatëse, megjithatë nga të dhënat e lartë-përshkruara, ZRRE ka llogaritur koston totale të personeli në vlerë prej 2,994,800€. Duke marre proporcionin e zakonshëm në shqyrtimet e kaluara tarifore, është llogaritu **kostoja e personelit 'puna jo-direkte'** në shumën **1,407,556€**, të cilën e lejon për periudhën e shqyrtimit tarifor 2026/'27.

- **Kostot e shitjes dhe tjera administrative**

  - Kjo kosto është fillimisht është propozuar nga NQ Termokos në vlerë 1,869,787 €; nga detajimet e ofruara është vërejtur se nën këtë pozicion janë përfshirë edhe nën-komponentët: blerja e kompjuterëve dhe licencave për programet kompjuterike në vlerë totale 125,000 € dhe "shpenzimet e tatimit në fitim' në vlerën 152,988 €, si dhe shpenzime tjera kryesisht për konsulencë në vlera monetare mjaft të larta. Në komentet e ZRRE-së është dhënë vërejtja se, fitimi përfshirë edhe tatimin në fitim, bazuar në metodologjinë tarifore, adresohet në Kthimin e Lejuar, i cili llogaritet bazuar në Bazën e Aseteve të Rregulluar me një normë kthim të arsyeshme sipas Mesatares së Ponderuar të Kostos së Kapitalit (WACC), prandaj kjo nën-komponentë nuk mund të përfshihet në Kostot e shitjes dhe tjera administrative. Gjithashtu edhe për blerjet e kompjuterëve dhe licencave të programeve kompjuterike është dhënë sqarimi se i përkasin investimeve dhe nuk duhet të përfshihen në këtë pozicion. Në ri-dorëzimin e aplikacionit të përmirësuar NQ Termokos ka zbritur vlerat e lartë-përshkruara, dhe shuma e ri-propozuar është 1,061,055€.

- Vlerësimi – NQ Termokos, pas pranimit të komenteve, ka bërë disa përmirësime në aplikacionin e ridërguar. Megjithatë, ende janë evidentuar disa kosto, si ato për shërbimet e konsulencës, licencat e softuerit dhe mirëmbajtjes, të cilat janë paraqitur si në kostot të dyfishta, si tek kostot operative pra tek 'Kostot e shitjes dhe tjera administrative' ashtu edhe në pasqyrën e investimeve. Një paraqitje e tillë mund të konsiderohet si tentim për dyfishimin kostove që është e pa pranueshme nga ana e ZRRE-së. Prandaj ZRRE ka zbritur koston e lartë përshkruara dhe lejon vlerën e aryeshme prej **446,055 €** për Kostot e shitjes dhe tjera administrative**.**

Nga më lartë rezulton se **Kostot Fikse** të pranuara / lejuara nga ZRRE-ja, janë përcaktuar në vlerën **3,505,078€.**

- Total Kostot operative të lejuara për sezonin 2026/2027

Kostot operacionale të lejuara përbëhen nga shuma e kostove fikse dhe atyre variabël, dhe janë llogaritur sipas formulës së shënuar më poshtë:

OC = Kostot Variabile + Kostot Fikse

Nga formula llogariten:

Kostot operative të lejuara në vlerë prej **7,700,052€**

3.2 Përcaktimi i Bazës së Rregulluar të Aseteve (RAB)

Përcaktimi i RAB-it është komponenti kryesor për llogaritjen e Zhvlerësimit vjetor dhe Kthimit të lejuar në asete, që në fakt paraqet fitimin e lejuar nga aktiviteti afarist i rregulluar.

Baza e Rregulluar e Aseteve - RAB, në pajtim me shtojcën 2 të Rregullës për vendosjen e Çmimeve të Energjisë Termike llogaritet sipas formulës:

$$RAB_n^{\text{përf.}} = RAB_n^{\text{fill.}} + INV_n + WC_n - DEP_{n-1} - DIS_{n-1}$$

ku:
$RAB_n^{\text{përf.}}$ – paraqet asetet e planifikuara për sezonin 2026/27 ('n');
$RAB_n^{\text{fill.}}$ – Bazën e Rregulluar të Aseteve fillestarë, që faktikisht paraqet RAB-in përfundimtarë të realizuar në sezonin paraprak 2025/26 ('n-1');
INV_n – Investimet e reja të planifikuara dhe të aprovuara nga rregullatori për periudhën njëvjeçare që përfshinë sezonin e ngrohjes 2026/2027;
WC_n – Kapitali i mjaftueshëm punues për kompaninë që të kryejë aktivitetet e saj;
DEP_{n-1} – Zhvlerësimin e aseteve të realizuar në sezonin paraprak 2025/26 ('n-1'); dhe
DIS_{n-1} – Asetet e tjetërsuara në sezonin paraprak 2025/2026 ('n-1').

3.2.1 Përcaktimi i Bazës së Rregulluar të Aseteve Fillestarë (RABnfill.)

$RAB_n^{\text{fill.}}$ paraqet bazën fillestare për përcaktimin e RAB-it të planifikuar për sezonin 'n' – 2026/27, e që, siç u theksua më lartë, faktikisht është RAB-i përfundimtarë i realizuar në sezonin paraprak 'n-1' – 2025/26.

Nga monitorimi i rregullt i realizimeve, ku kryesisht fokusi është në monitorimin e realizimit të investimeve në raport me ato të planifikuara (Raporti i Monitorimit të realizimeve për sezonin

2025/2026), janë konstatuar vlerat e realizuara prej nga llogaritet RAB përfundimtarë i realizuar në sezonin 'n-1' – 2025/26 në vlerë **70,268,932 €**, që njëkohësisht paraqet RAB-in fillestarë për sezonin 'n' -2026/27.

3.2.2 Përcaktimi i Investimeve të reja të lejuara

Lidhur me Investimet e reja të planifikuara për periudhën e shqyrtimit tarifor: tetor 2026 – tetor 2027, fillimisht duhet theksuar se këto investime kryesisht ndërlidhen me projektin: Impianti për përfitimin e energjisë termike nga energjia diellore (Projekti i KfW-EU-EBRD: 'Solar4Kosova') dhe impiantet për dyfishimin e kapacitetit të ko-gjenerimit (Projekti i EU-EIB); janë planifikuar bashkëfinancimet për projektin e MCC instalimit të matësve të energjisë termike në nivel apartamenti dhe për projektin e KfW rehabilitimi i rrjetit e nënstacioneve dhe zgjerimit të rrjetit e nënstacione të reja. Gjithashtu janë parashikuar edhe investime me vetë-financim në zgjerimin e rrjetit në lagjen Lakrishtë, si dhe në stabilimentet e pajisjet e ko-gjenerimit dhe në objektin administrativ. NQ Termokos ka paraqitur vlerën totale të **investimeve të reja të planifikuara 15,482,453 €**; pra në këtë shumë janë përfshirë investimet nga donacionet, bashkëfinancime në projektet e donatorëve dhe investimet me vetë-financim – detajet në vijim:

<u>Investimet nga donacionet</u>

Në kuadër të projekteve të donatorëve ndërkombëtarë është paraqitur investimi për projektin 'Solar4Kosova' në vlerë prej **12,177,879 €** – detajet në vijim:

- **Projekti i KfW 'Solar4Kosova"**: Projekt i iniciuar në kuadër të bashkëpunimit të Qeverisë sonë me EU, KfW dhe BERZH, për prodhimin e energjisë termike nga energjia diellore, në vlerë të parashikuar të investimit prej rreth 86.22 mil. €. Ky projekt planifikohet të financohet në kombinim grant-kredi-bashkëfinancim si në vijim:

  - BERZH: kredi 23 mil. €;
  - KfW: kredi 31.6 mil. €;
  - WBIF-KfW: grant 21.5 mil. €; dhe
  - Termokos: Bashkëfinancim 10.12 mil. €.

  Me këtë projekt parashihet instalimi i paneleve solare për ngrohjen e ujit në një hapësirë prej 58 mijë metra katrorë, me kapacitetit termik 50 MW, dhe ndërtimi i një rezervuari të energjisë ngrohëse me një kapacitet prej 400 mijë m^3. Me realizimin e këtij projekti, planifikohet zgjerimi i rrjetit dhe kyçja në rrjetin e ngrohjes për rreth 12 mijë konsumatorë të ri me sipërfaqe të përgjithshme 1,016,931 m^2 në lagjet Tophane, Gjinaj, Kalabria, Lakrishtë dhe Mahalla e Muhaxherëve.

  Sa i përket zhvillimeve për këtë projekt, NQ Termokos ka dërguar shpjegimet shtese, ku është theksuar se janë në vijim punët përgatitore për fillimin e ekzekutimit të projektit, ku janë kryer:
  - Studimi i fizibilitetit,
  - Projekti VNMS (Vlerësimi i Ndikimit Mjedisor dhe Social), i punuar nga CES-iC dhe financuar nga KFW,
  - Është definuar dhe aprovuar lokacioni në zonën Hade e Re prej 25 ha tokë, për vendosjen e paneleve solare dhe rezervuarit të energjisë ngrohëse,

- Është nënshkruar kontrata me kompaninë konsulente për projektin në janar 2024,
- Aprovimi dhe prezantimi publik i Master Planit të përditësuar për Zgjerim dhe përcaktimi i prioriteteve për zonat Lakrishte, Kalabria, Tophane, Mahalla e Muhaxherëve dhe Gjinaj, përfshirë simulimet hidraulike dhe verifikimin e kapaciteteve të rrjetit ekzistues.
- Përfundimi i koncept-dizajnit dhe dizajnit teknik për impiantin diellor, rezervuarin për deponimin e nxehtësisë dhe ndërtesën energjetike;
- Nënshkrimi i Marrëveshjes së Mirëkuptimit me MMPH për përdorimin e korridorit rrugor për Korridorin B.
- Finalizimi dhe publikimi i Planit të Angazhimit të Palëve të Interesit (SEP) në faqen zyrtare të Termokos-it, si dhe përditësimi dhe publikimi i dokumenteve LALRP/LALRF.
- Dorëzim i pakove kryesore të FOPIP-it, Planit të Zhvillimit Korporativ (CDP) dhe Planit të Integruar të Menaxhimit të Aseteve, si bazë për forcimin e performancës financiare dhe operative të ndërmarrjes.
- Përfundimi i elaboratit të shpronësimit për Korridorin A dhe dorëzimi i tij në MMPH, do të ri-dorëzohet përsëri.
- Rishikimi dhe harmonizimi i dokumenteve mjedisore dhe sociale me KfW dhe BERZH.
- Marrja e pëlqimeve parimore për kyçje ne rrjetin e ujësjellësit dhe kanalizimeve si dhe ne sistemin energjetik (për impiantin solar).
- Vazhdon koordinimi intensiv me Komunën e Prishtinës, Drejtorinë e Kadastrit dhe MMPH për çështjet e shpronësimit;
- Është në proces përzgjedhja e operatorëve për para-kualifikim.

Gjithashtu sipas informatave nga NQ Termokos, aktivitetet e planifikuara për periudhën raportuese janë :

- Planifikohet që projekti të kalojë nga faza e tenderimit në fazën fillestare të zbatimit.
- Për Lot 1, planifikohet finalizimi i tenderimit dhe nënshkrimi i kontratës rreth fundit të vitit 2026,
- Përgatitja e dizajnit të detajuar dhe marrja e lejeve ndërtimore deri në mes të vitit 2027,
- Fillimi i punimeve për PTES nga mesi i vitit 2027.
- Për Lot 2, pritet finalizimi i procedurës tenderuese, nënshkrimi i kontratës në fillim të vitit 2027, përgatitja e dizajnit të detajuar dhe procedurat e lejeve për gypat A+B.
- Punimet për gypat lidhës dhe zgjerimin e rrjetit parashihen të fillojnë gjatë vitit 2027.
- Paralelisht, duhet të adresohen çështjet kyçe si shpronësimi/servituti për Gypin A dhe B, sigurimi i tokës për booster pumping station, lejet mjedisore/ndërtimore, finalizimi i rrjetit të zgjerimit dhe çështja e Lakrishtës.
- Koordinimi i vazhdueshëm me institucionet financiare ndërkombëtare, donatorët dhe institucionet relevante kombëtare;

NQ Termokos, për periudhën e shqyrtimit tarifor 2026/’27, ka paraqitur vlerën e planifikuar të realizimit në vlerë prej 12,177.879€, nga të cilat 11,144,735 € (pagesë avansi) të dedikuara për zhvillimin e projektit dhe 1,033,144€ për shërbimet e konsulencës.

Investimet me bashkëfinancim në projektet e donatorëve

NQ Termokos ka paraqitur vlerën totale prej 950,660 €, ku hyjnë bashkëfinancimet për:

- **Projektin e KfW**: Rehabilitimi i rrjetit dhe nënstacioneve, si dhe zgjerim të rrjetit dhe nënstacione termike të reja; ky është projekt në vijim e sipër - ka filluar të realizohet në vitin 2021; ky projekt përfshinë këto komponente:

  1) Rehabilitimi / modernizimi i 235 nënstacioneve ekzistuese, instalimi i 333 nënstacioneve të reja, instalimi i rezervuarëve të ngrohjes me kapacitet 2x400 m^3, rinovimi dhe zgjerimi i sistemit të pompave qarkulluese të rrjetit, rehabilitimi i sistemit të mbajtjes së presionit dhe trajtimit kimik të ujit në rrjetin primar të shpërndarjes dhe instalimi i SCADA-s; vlera kontaktuese pas shtesave 8.4 mil €.
  2) Rehabilitim i rrjetit në gjatësi tubacioni 12,358 m, zgjerimi i rrjetit në gjatësi tubacioni 23,524m, dhe dendësim i rrjetit me gjatësi tubacioni prej 5,958m; vlera kontraktuese pas shtesave 7.6mil€;

  Për komponentët e lartë-përshkruara janë dhënë detaje paraprake, ku duhet përmendur se, aktualisht të dy komponentët janë përfunduar.

  Për këtë projekt NQ Termokos ka paraqitur vlerën prej 415,000€, që i përket Kontratës T1: Furnizimi dhe instalimi i depozitimit të ngrohjes, nënstacioneve termik, impiantit të trajtimit kimik të ujit dhe SCADA-s; Vlera e lartë-cekur ka të bëj me pagesë e mbetur prej 5% të vlerës kontratës, e cila duhet paguar nga NQ Termokos si bashkëfinancues i projektit.

- **Fazën e dytë të Projektit 'Prishtina Heat Save'**: Instalimi i matësve të energjisë termike – Faza e dytë e këtij projekti përmban këto komponente kryesore:

  - Instalimin e rreth 6,848 alokatorëve të nxehtësisë (HCA) dhe 744 matësve individual të energjisë termike;
  - Instalimin e 12,347 valvulave termostatike në radiatorët e konsumatorëve (apartamenteve dhe njësive komerciale);
  - Pompat qarkulluese: 105, dhe valvolat balancuese: 171;
  - Asistencë në përmirësimin e shërbimeve të faturimit bazuar në konsumin e matur.

NQ Termokos ka ofruar edhe detajimet e të gjitha pajisjeve, ku janë paraqitur ndarazi sasitë e pajisjeve shtesë që do të instalohen me bashkëfinancim e shoqëruar me shpjegimet përkatëse – i) 900 pajisje matëse, ii) 238 valvola termostatike; iii) shërbimet e konsulencës . Për këto komponente NQ Termokos ka paraqitur vlerën totale të bashkëfinancimit prej 218,587 €, nga ku 208,707 € janë për instalimet e pajisjeve të lartë përshkruara dhe 9,880 € për shërbimet ë konsulencës.

- **Projekti i KfW 'Solar4Kosova"**:

Për këtë projekt që detajisht është më lartë, NQ Termokos ka paraqitur vlerën e bashkëfinancimit prej 317,073€, për komponentët si në vijim: i) zotimi i kredisë: 117,073€; dhe ii) punët shtesë për dizajn dhe mbikëqyrje: 200,000€.

Investimet me vet-financim të projekteve individuale

Siç u përmend më lartë, NQ Termokos planifikon edhe investime me financim vetanak në projekte individuale, ku ka paraqitur investime në vlerë totale prej **2,353,914 €.**

Investimet me vet-financim të projekteve individuale janë ndarë sipas njësive funksionale të ndërmarrjes në prodhim, shpërndarje dhe investimet e përbashkëta – detajet në vijim:

- **Prodhimi** – Stabilimentet dhe pajisjet e ko-gjenerimit të planifikuara në vlerë totale 780,998 € për periudhën 2026/'27. Në planifikimet e investimeve në prodhim janë përfshirë pajisjet e stabilimenteve të Stacioneve të ekstraktimit dhe pranimit të energjisë termike (HES dhe HRC – pjesë përbërëse e sistemit të ko-gjenerimit), si dhe pajisje tjera si elektromotorë të pompave, këmbyes të nxehtësisë e pajisje tjera. Ndër komponentët e këtyre pajisjeve të prodhimit duhet theksuar: i) Furnizim me fletëza dhe diktuna për këmbyes të nxetsisë 50MW me shërbim (me montim) KN-B7:D252 në vlerë 120,000 €; dhe ii) Ndërrimi i kthinave dhe transformatorëve të tensionit të mesëm 10/20kV, në vlerë 200,000€.

- **Shpërndarja** – Në sistemin e shpërndarjes planifikohet shuma totale e investimit prej 946,358 €, e cila shumë ndahet për: i) Projekti për Ndërrimin e trasesë dhe gypit për lagjen Mati 1, në vlerë 600,000€; ii) Projektin e zgjerimit të rrjetit në Lagjen Lakrishtë – shuma e pa paguar në vlerë 82,358€; dhe iii) shuma e investimit prej 264,000 € planifikohet për rehabilitim dhe riparim të rrjetit të shpërndarjes dhe nënstacioneve termike, ku përfshihet tubacione e fitingje dhe pajisje tjera të ndërlidhura, matës të ngrohjes, pompa qarkulluese, këmbyes të nxehtësisë, automjete të punimeve të dheut etj.

- **Zhvillimi dhe Investimet kapitale** – ky segment i investimeve i paraqitur në shumë të përgjithshme 139,500€ përfshin 2 komponente: i) Licencat për softwer, mirëmbajtje ('help desk support') për aplikacionet STANET,QGIS,SCADA; dhe ii) shërbime konsulence për balancim hidraulik të rrjetit të shpërndarjes.

- **Administrata dhe shërbimet e përbashkëta –** në vlerë totale 487,058 € ku hyjnë: i) pagesat e mbetura për ndërtimin e Ndërtesës së Drejtorisë dhe Administratës dhe renovimin e hapësirave përcjellëse në vlerë prej 362,058 €; dhe Pajisje kompjuterike dhe licencat e programeve kompjuterike në vlerë 125,000 €.

Përmbledhje e vlerësimeve të ZRRE-së për Investimet e reja të lejuara

Investimet nga donacionet

ZRRE ka përcjellur në vazhdimësi zhvillimin e projekteve investive dhe në kuadër të bashkëpunimit me palët e kyçura në këto projekte është informuar saktësisht për detajet e këtyre projekteve. Duhet theksuar se projekti i paraqitur ('Solar Thermal' – KfW) është i përfshirë gjithashtu në Planin zhvillimorë dhjetë-vjeçar 2022 – 2031 të NQ Termokos, i cili është aprovuar nga ZRRE.
Është e nevojshme të theksohet se një numër i këtyre projekteve posaçërisht të projekteve nga donatorët ka kohëzgjatjen mbi një vit, kështu që ka qenë e nevojshme vlerësimi i punimeve që planifikohen të realizohen brenda periudhës së shqyrtimit tarifor. Konkretisht:

- **Projekti i KfW 'Solar Thermal'** – NQ Termokos, për periudhën e shqyrtimit tarifor 2026/'27, ka paraqitur vlerën e planifikuar të realizimit në vlerë prej **12,177,879€,** nga të cilat 11,144,735 € (pagesë avansi) të dedikuara për zhvillimin e projektit dhe 1,033,144€ për shërbimet e konsulencës.

  Në vlerësimin e planifikimeve për këtë projekt, i referohemi statusit aktual të këtij projekti të përshkruar detajisht më lartë (shih fq. 16-17), i cili është në fazën përgatitore dhe të tenderimit për përzgjedhjen e kompanisë për ekzekutimin e punimeve – planifikohet që procesi i përzgjedhjes së kryesit të punimeve të finalizohet në fund të vitit 2026 (për LOT 1) respektivisht gjysmën e parë të viti 2027 për LOT 2, dhe më pastaj të filloj ekzekutimi i punimeve.

  Lidhur me planifikimet duhet theksuar se janë shënuar vonesa të fazës përgatitore të projektit e sidomos në tenderimin për përzgjedhjen e kompanisë për ekzekutimin e punëve ndërtimore dhe instalues. Konkretisht në shqyrtimin e kaluar tariforë kemi lejuar shumën prej 2.5 mil €, duke ju referuar planifikimeve të atëhershme të projektit ku është paraparë që gjatë gjysmës së parë të vitit 2026 të filloj realizimi i projektit. Mirëpo gjatë monitorimit të realizimeve të sezonit 2025/'26 është konstatuar se nuk ka pasur ndonjë realizim.

  Duke marrë parasysh statusin aktual të projektit dhe vonesat gjatë fazës përgatitore, procesit të tenderimit dhe fillimit të punimeve, ZRRE vlerëson se shuma e propozuar prej 12,177,879 € për periudhën e shqyrtimit tarifor nuk reflekton një planifikim realist, si në aspektin e kohëzgjatjes ashtu edhe të vëllimit të punëve që mund të realizohen në këtë periudhë. Gjithashtu duhet ritheksuar se dedikimi i mjeteve për investim të punëve përgatitore dhe projektuese nuk konsiderohen detyrimisht investim specifik në asete. Bazuar në këto vlerësime ZRRE për këtë periudhë nuk pranon vlerën e paraqitur për këtë projekt investiv; ZRRE vlerëson se shuma prej **1.5 mil. €** pasqyron një planifikim më realist duke ju referuar mos realizimit në sezonin e kaluar, statusit aktual të projektit dhe parashikimeve për përfundimin e fazës përgatitore dhe të fillimit të punimeve. Prandaj kjo shumë vlerësohet të jetë e mjaftueshme për fazën fillestare të ekzekutimit të projektit, e cila pranohet si investim i ri për periudhën një-vjeçare të shqyrtimit tarifor 2026/'27.

Nga sa është përshkruar më lartë **Investimet e reja të lejuara si donacione** për periudhën e shqyrtimit tarifor (tetor 2026 – tetor 2027) janë në vlerën totale **1,500,000€**.

Investimet e reja me vetë-financim

- **Investimet bashkëfinancim në projektet e donatorëve**

NQ Termokos ka paraqitur në total shumën prej 950,660 € si bashkëfinancim për projektet e donatorëve, si në vijim:

- **Projekti i KfW Zgjerimi dhe Rehabilitimi i rrjetit dhe nënstacione**: Për këtë projekt NQ Termokos ka paraqitur vlerën prej 415,000€, që i përket Kontratës T1: Furnizimi dhe instalimi i depozitimit të ngrohjes, nënstacioneve termik, impiantit të trajtimit kimik të ujit dhe SCADA-s; Vlera e lartë-cekur ka të bëj me pagesë e mbetur prej 5% të vlerës kontratës, e cila duhet paguar nga NQ Termokos si bashkëfinancues i projektit.

  Ky projekt që ka filluar të realizohet para 3 viteve ka pasur shtesa të konsiderueshme nga vlera fillestare e parashikuar e projektit. Shtesat e projektit janë kryesisht për shkak të shtimit të punimeve për zgjerim të mëtejmë të rrjetit në 5 lagjet të qytetit, që përfshinë edhe nënstacionet e reja, e gjithashtu për punimet në rezervuarët e ngrohjes dhe sistemet e trajtimit të ujit dhe

mbajtjes së presionit. Pasi që shuma planifikuar si donacion është shpenzuar, NQ Termokos në bashkëpunim me donatorët janë dakorduar për të vazhduar punimet shtesë me bashkëfinancim nga NQ Termokos.

Për sa i përket planifikimeve dhe shtesave të investimeve, konkretisht si në vijim:

- Planifikimet fillestare të projektit në fazën përgatitore të projektit kanë qenë rreth 14 mil. €, shumë kjo që ka qenë e përfshirë në Planin Zhvillimorë 2019-2029 të aprovuar nga ZRRE;
- Në e Planin e azhurnuar zhvillimorë 2022-2031, gjithashtu të aprovuar nga ZRRE, shuma e planifikuar e investimit ka qenë 16 mil. €;
- Ndërsa përfundimisht në vitin 2024 duke përshirë edhe shtesat e punimeve në kuadër të këtij projekti investiv shuma e planifikuar e investimit ka arritur në mbi 20mil.€.

Nga monitorimet e realizimit të këtij projekti investiv, në sezonet e kaluara është konstatuar se kjo shumë është mbi-realizuar në krahasim me vlerë e lejuar në planin e përditësuar zhvillimor. Rrjedhimisht duke ju referuar shumës totale të realizimeve të konstatuara në Raportet e monitorimeve për periudhat e kaluara konkludohet se shuma e lejuar në Planin e azhurnuar zhvillimorë 2022-2031 prej 16 mil. € është tejkaluar.

Po ashtu nisur nga fakti se pothuajse të gjitha punimet instaluese të pajisjeve janë përfunduar, ZRRE e konsideron të përfunduar këtë projekt dhe **nuk lejon ndonjë shumë financiare** si planifikim të investimeve të reja.

- **Faza e dytë e Projektit 'Prishtina Heat Save':** Instalimi i matësve të energjisë termike – për komponentët e këtij projekti NQ Termokos ka paraqitur vlerën totale të bashkëfinancimit prej 218,587 €, nga ku 208,707 € janë për instalimet e pajisjeve të lartë përshkruara dhe 9,880 € për shërbimet ë konsulencës.

Për këtë propozim ka dhënë detaje për instalimet e pajisjeve siç janë përshkruar më lartë (shih fq. 18) dhe shpjegimet përkatëse të ecurisë së punimeve instaluese, dhe informata dhe të dhëna lidhur me numrin e matësve, numrin e banesave gjegjësisht të konsumatorëve, numrin dhe lokacionin e ndërtesave e tjera detaje që janë të nevojshme për një vlerësim meritorë të investimit të propozuar.

ZRRE vlerëson se instalimi i këtyre pajisjeve është i rëndësishëm për funksionalizimin e plotë të matjes në nivel apartamenti dhe zbatimin korrekt të faturimit bazuar në konsumin e matur të ngrohjes. Gjithashtu vlerësohet se është shumë e rëndësishme që të vazhdohet me instalimin e matësve në nivel apartamenti (HCA dhe matës individual të ngrohjes) ashtu që të shtohet edhe mëtutje numri i konsumatorëve të pajisur me këta matës. Këto masa janë thelbësore për rritjen e zbatimit të matjes në nivel apartamenti, duke mundësuar zbatimit sa më të plotë të faturimit të bazuar në matjen e konsumit, me çka pritet të arrihet kursimi i energjisë për ngrohje.

Nga sa u përshkrua më lartë, ZRRE e pranon si **bashkëfinancim** shumën e propozuar prej **208,707€** nga NQ Termokos për instalimet e pajisjeve matëse për konsumatorët e përfshirë në projektin 'Prishtina Heat Save'. Njëkohësisht, me qëllim të zgjerimit të mëtejshëm të matjes në nivel apartamenti, lejon një shumë shtesë prej **400,000€** për instalimin e matësve të ngrohjes në ndërtesat tjera të kyqyra në sistemin e ngrohjes të NQ Termokos. Për këtë pjesë të investimit shtesë ZRRE kërkon nga NQ Termokos që të hartoj planin e instalimit të pajisjeve matëse duke specifikuar numrin e ndërtesave në të cilat do të instalohet matësit, numrin e apartamenteve / konsumatorëve, numrin dhe llojin e pajisjeve matëse që do të instalohen, të shoqëruar me analizat financiare përkatëse, si dhe me analizën e kursimit të energjisë për ngrohje.

Duke ju referuar arsyetimit të cekur më lartë, **shuma totale e lejuar e investimit për instalimin e pajisjeve matëse në nivel apartamenti arrin në 608,707€.**

- **Projekti i KfW 'Solar4Kosova"**: Për këtë projekt, NQ Termokos ka paraqitur vlerën e bashkëfinancimit prej 317,073€, për komponentët si në vijim: i) zotimi i kredisë: 117,073€; dhe ii) punët shtesë për dizajn dhe mbikëqyrje: 200,000€.

  Lidhur me këto 2 komponente duhet theksuar se të njëjtat janë paraqitur si pozicione të kostove nën kategorinë: 'Kostot tjera administrative dhe të shitjes', të cilat janë pranuar si kosto operative; kështu që këto komponente nuk pranohen si investime me bashkëfinancim.

  Nga sa u përshkrua më lartë, për këtë shqyrtim tarifor ZRRE pranon vlerën financiare prej **608,707 € si bashkëfinancim** për projektet e donatorëve.

- **Investimet me vetëfinancim të projekteve individuale**

Fillimisht duhet theksuar se investimet e paraqitura nga NQ Termokos kryesisht janë në përputhje me planin zhvillimor dhjetë-vjeçar me disa shmangie në afatet kohore dhe në vlerat respektive. Gjithashtu duhet përmendur faktin se gjatë monitorimit të realizimit të investimeve për periudhën e kaluar, ZRRE ka konstatuar se realizimi i investimeve me vetëfinancim ka qenë nën planifikimet – rreth 70%. Megjithatë duhet theksuar se shumica e investimeve të planifikuara kanë të bëjnë kryesisht me përmirësimin e vazhdueshëm të operimeve dhe furnizimit të qëndrueshëm me përjashtim të disa projekteve investive. Konkretisht vlerësimet si në vijim:

- **Investimet në Stabilimentet e bashkë-prodhimit të energjisë termike** – për periudhën e shqyrtimit tariforë 2026/'27 janë propozuar nga NQ Termokos në vlerën totale prej 780,998 €, ku kryesisht janë investime në stabilimentet dhe pajisjet e ko-gjenerimit. Në planifikimet e investimeve në prodhim janë përfshirë pajisjet e stabilimenteve të Stacioneve të ekstraktimit dhe pranimit të energjisë termike (HES dhe HRC – pjesë përbërëse e sistemit të ko-gjenerimit), si dhe pajisje tjera si pompa elektromotorë të pompave, këmbyes të nxehtësisë e pajisje tjera.

  Veçanërisht duhet theksuar 2 komponentët: i) Furnizim me fletëza dhe diktuna për këmbyes të nxehtësisë 50MW me shërbim (me montim) KN-B7:D252 në vlerë 120,000 €; dhe ii) Ndërrimi i kthinave dhe transformatorëve të tensionit të mesëm 10/20kV, në vlerë 200,000€.

  Komponenti i parë është i njëjti projekt investiv i cili është deklaruar dhe konfirmuar me raportin e realizimeve si i kryer në periudhën paraprake (që përfshin sezonin 2025/'26); pra nuk pranohet. Ndërsa komponenti i dytë është shtuar në ri-dorëzimin e përmirësuar të aplikacionit tarifor, por që nuk janë dhënë asnjë shpjegim apo detaje përkatëse për këtë komponentë, kështu që gjithashtu nuk pranohet. Rrjedhimisht nga shuma totale e investimeve në prodhim zbritet shuma e këtyre dy komponentëve.

  Investimet tjera të planifikuara në stabilimentet e ko-gjenerimit të energjisë termike – HES dhe HRS, janë në kuadër të investimeve të rregullta për të ruajtur nivelin e operimit të ko-gjenerimit dhe siguruar furnizim cilësor me energji termike. Rrjedhimisht, nga sa u përshkrua më lartë, ZRRE **lejon** shumën prej **460,998 €** për investimet në stabilimentet e prodhimit të energjisë termike nga ko-gjenerimi.

- **Investimet në rrjetin e shpërndarjes** – NQ Termokos për periudhën e shqyrtimit tarifor ka propozuar shumën totale e investimit prej 946,358 €, për investim në sistemin e shpërndarjes. Kjo shumë ndër tjera përmban edhe komponentën e Projektit për Ndërrimin e trasesë dhe gypit për lagjen Mati 1, në vlerë 600,000€. Ndërsa dy komponentët tjera në vlerë 346,358€ i përkasin: Projektit për zgjerimin e rrjetit në lagjen Lakrishtë (shuma e pa paguar në vlerë 82,358€); dhe për rehabilitim dhe riparim të rrjetit të shpërndarjes dhe nënstacioneve termike (264,000 €).

  Lidhur me komponentën – projektin për ndërrimin e trasesë dhe tubacionit në lagjen Mati 1, duhet theksuar se NQ Termokos ka dërguar një shpjegim të shkurtër ku është dhënë arsyetimi për këtë projekt dhe vlerën përkatëse të investimit – për të rritur cilësinë e furnizimit me ngrohje në këtë lagje. Duke qenë në dijeni të këtij problemi teknik që ndikon në cilësinë e ngrohjes ZRRE, **lejon shumën e propozuar prej 600,000 € për këtë projekt**. Lidhur me këtë ZRRE kërkon nga NQ Termokos të dorëzoj analizë / studimin teknik dhe financiarë për këtë projekt përfshirë edhe planin dinamik të ekzekutimit të projektit.

  Përndryshe investimet e tjera të paraqitura për sistemin e shpërndarjes së energjisë termike vlerësohet se janë të nevojshme për të siguruar operim të sigurt dhe përmirësim të shërbimeve. Veçanërisht i rëndësishëm vlerësohet zgjerimi i rrjetit në Lakrishtë në pjesën me ndërtesa shumëkatëshe.

  Rrjedhimisht duke ju referuar përshkrimit më lartë, ZRRE **pranon investimet** në sistemin e shpërndarjes në vlerën prej **946,358 €.**

- **Zhvillimi dhe Investimet kapitale** – ky segment i investimeve i paraqitur në shumë të përgjithshme 139,500€ përfshin d komponente: i) Licencat për softwer, mirëmbajtje (‘help desk support’) për aplikacionet STANET,QGIS,SCADA; dhe ii) shërbime konsulence për balancim hidraulik të rrjetit të shpërndarjes.
  Lidhur me këto investime, përveç faktit që NQ Termokos nuk ka dhënë shpjegimet dhe detajimet përkatëse, duhet theksuar se për komponentin e parë i një pozicion ë paraqitur si shpenzim operativ në kategorinë e ‘kostove të shitjes dhe tjera administrative’; gjithashtu komponenti i dytë si shërbim konsulence nuk mund të kategorizohet si projekt investiv zhvillimorë.

  Prandaj, duke konsideruar sa u përshkrua më lartë investimet e propozuara në këtë kategori nuk pranohen.

- **Investimet në administratë dhe shërbimet e përbashkëta** – NQ Termokos ka propozuar investime në vlerën totale 487,058 € të cila ndahen:
  - Investimet shtesë për ndërtimin e ndërtesës administrative dhe drejtorisë në vlerën 362,058€; dhe
  - Investimet në pajisje dhe programe kompjuterike në vlerë 125,000 €.

  Lidhur me investimet në ndërtesë administrative duhet theksuar se, në raportin e monitorimit të realizimeve të periudhës kaluar (sez. 2025/’26) është konstatuar dhe pranuar realizimi i tërësishëm i këtij projekt (në fakt një mbi realizim prej rreth 70,000 € ose 6%), që ka përshirë edhe renovimin e hapësirave përcjellëse. Pra në këtë kuptim ZRRE nuk pranon investimin shtese për këtë projekt.

  Përderisa komponenti i investimeve në pajisjet dhe programet e licencat kompjuterike **pranohet** në vlerën e propozuar prej **125,000€.**

Duke ju referuar këtyre vlerësimeve për investimet në administratë dhe shërbimet e përbashkëta ZRRE pranon vlerën prej **125,000 €**.

Nga më lartë Investimet me financim vetanak të projekteve individuale të NQ Termokos përcaktohen në **1,532,356 €**.

Vlera e përgjithshme e investimeve të reja të lejuara dhe ndarja sipas mënyrës së financimit:

Bazuar në vlerësimet e paraqitura më lartë ZRRE pranon gjegjësisht lejon Investimet e reja të planifikuara për periudhën e shqyrtimit tarifor (tetor 2026 – tetor 2027) në vlerë totale prej **3,641,062€.**

Duke ju referuar detajeve të financimit të përshkruara më lartë ndarja e Investimeve të reja të lejuara sipas mënyrës së financimit është si më poshtë:

- **(Investimet e reja të lejuara)$_{DONACION}$ = 1,500,000 €; dhe**
- **(Investimet e reja të lejuara)$_{VETFINANC.}$ = 2,141,063 €.**

3.2.3 Përcaktimi i Kapitalit Punues

Sipas dispozitave përkatëse të Rregullës për Vendosjen e Çmimeve të Energjisë Termike – Shtojca 2, kapitali punues zakonisht përcaktohet për të lejuara mjete monetare qarkulluese për një periudhë jo më të gjatë se një muaj respektivisht vlerën e të hyrave mesatare mujore. Rrjedhimisht, ZRRE përcakton raportin 1/12 në të hyrat nga shitja e ngrohjes të realizuara në sezonin e kaluar 2025/2026 – 10,600,025 €, dhe lejon **kapitalin punues** në vlerën **883,335 €.**

3.2.4 Zhvlerësimi Vjetorë i Aseteve - realizuar në sezonin 2025/26 ('n-1')

Zhvlerësimi vjetorë i realizuar në sezonin 'n-1' – 2025/26 llogaritet duke u bazuar në Bazën e Aseteve të Rregulluar (RAB) të realizuar në atë sezonë dhe mesataren e ponderuar të normës së zhvlerësimit; më konkretisht, nga Vlera e RAB të realizuar në 2025/26 (72,488,392 €) zbritet vlera e kapitalit punues të realizuar (883,335 €), dhe shuma e fituar (69,385,597 €) shumëzohet me mesataren e ponderuar të normës së zhvlerësimit (3.32%). Pra nga kjo llogaritet **Zhvlerësimi vjetor i realizuar në sezonin 2025/26** në vlerën **2,304,937 €.**

3.2.5 Tjetërsimet

Me tjetërsim nënkuptohen asetet që ndërmarrja e rregulluar i ka hequr nga përdorimi – asetet që janë dëmtuar në atë masë sa që nuk mund të riparohen dhe të përdoren përsëri, asetet që eventualisht janë shitur/huazuar (kur janë vlerësuar të papërdorshme) etj.; Sipas formulës së dhënë në fillim të kapitullit 3.2, vlera e aseteve të tjetërsuara është e zbritshme (minusohet). Duke qenë se në këtë shqyrtim tarifor nuk është raportuar ndonjë tjetërsim i aseteve, vlera për tjetërsimet është 0€.

<u>Përmbledhje e përcaktimit të RAB-it dhe RAB$_f$</u>

Në tabelën vijuese paraqiten të përmbledhura komponentët përbërës dhe vlerat respektive të Bazës së Rregulluar të Aseteve (RAB) dhe Bazës së Rregulluar të Aseteve të vetëfinancuara (RAB$_f$).

Tabela 2: RAB dhe komponentët e tij - NQ TERMOKOS sezoni i ngrohjes 2026/2027

	Baza e Rregulluar e Aseteve (RAB) - NQ TERMOKOS Sezoni i ngrohjes 2026-2027	Lejuar nga ZRRE [€]
3.2.1	Baza e Rregulluar e Aseteve fillestare(RAB_n^{fill})	70,268,932
3.2.2	Investimet e Reja (INV_n)	3,641,062
3.2.3	Kapitali Punues (WC_n)	883,335
3.2.4	Zhvlerësimi Vjetorë i Aseteve – realizuar në sezonin 2025/26 (DEP_{n-1})	-2,304,937
3.2.5	Tjetërsimet e aseteve – në sezonin 2025/26 (DIS_{n-1})	-
	Baza e Rregulluar e Aseteve (RAB)	**72,488,392**

Lidhur me Bazën e Rregulluar të Aseteve të vetëfinancuara (RAB_f) duhet theksuar se vlejnë të njëjtat formulime si për RAB-in e përgjithshëm, porse këtu merren vlerat e aseteve/investimeve të vetëfinancuara; detajet në tabelën e mëposhtme:

Tabela 3: RABf dhe komponentët e tij - NQ TERMOKOS sezoni i ngrohjes 2026/2027

	Baza e Rregulluar e Aseteve e vetëfinancuar (RAB_f)- NQ TERMOKOS Sezoni i ngrohjes 2026-2027	Lejuar nga ZRRE [€]
3.2.1	Baza e Rregulluar e Aseteve të vetëfinancuara - fillestarë ($RAB_{f-n}^{fill.}$)	24,353,645
3.2.2	Investimet e Reja (të vetëfinancuara - pa donacione) ((INV_{f-n})	2,141,062
3.2.3	Kapitali Punues (WC_n)	883,335
3.2.4	Zhvlerësimi Vjetorë i Aseteve të vetëfinancuara – realizuar në sezonin 2025/26 (DEP_{f-n-1})	670,580
3.2.5	Tjetërsimet e aseteve të vetëfinancuara - në sezonin 2025/26 (DIS_{n-1})	-
	Baza e Rregulluar e Aseteve e vetëfinancuar (RABf)	**26,707,463**

3.3 Vlerësimi dhe Përcaktimi i Zhvlerësimit Vjetor për sezonin 2026/2027

Përcaktimi i Zhvlerësimit vjetor për sezonin 2026/27 ('n') bazohet në vlerën e RAB-it total të përcaktuar në tabelën '2' (kapitulli '3.2') dhe në mesataren e ponderuar të normës së zhvlerësimit.

Norma mesatare e ponderuar e zhvlerësimit (NZH_{MP}) është llogaritur 3.31%. Bazuar në vlerën totale të (RAB-it minus Kapitali punues) dhe Normën mesatare të ponderuar të zhvlerësimit, llogaritet Zhvlerësimi vjetor i lejuar, si në vijim:

Zhvlerësimi vjetor i lejuar (DEP_n)=(Total RAB - WC_n) * NZH_{MP} = 71,605,057 € * 3.31 %= **2,373,415 €**

3.4 Përcaktimi i Kthimit të Lejuar në RAB (Fitimi i Lejuar)

Siç u përmend më parë, llogaritja/përcaktimi i Kthimit të lejuar llogaritet bazuar në Bazën e Rregulluar të Aseteve të vetëfinancuara RAB_f) dhe Normën e kthimit (RoR), pra përfshin dy komponentët në vijim:

- Përcaktimin (vendosjen) e Bazës së Rregulluar të Aseteve të vetëfinancuar (RAB_f); dhe

- Llogaritjen e Normës së Kthimit të lejuar (RoR), të përcaktuar në vlerën e WACC-ut.

Komponenta e parë - RAB_f është llogaritur në kapitullin 3.2 – tabela '3', ndërsa llogaritja e komponentës së dytë – RoR përcaktohet në kapitullin vijues:

3.4.1 Llogaritja e Normës së Kthimit (RoR) të Lejuar

Objektivi i Normës së kthimit të arsyeshme (RoR) në Bazën e rregulluar të aseteve (RAB), është që të garantoj ndërmarrjet e ngrohjes qendrore për një fitim që lejon të vazhdohet me investimet në asete, në mënyrë që të mund ti rehabilitoj dhe ti zgjeroj ato.

Një RoR i arsyeshëm konsiderohet të jetë norma e "Mesatares së Ponderuar të Kostos së Kapitalit" (WACC), që llogaritet në komponentët e bazës së kapitalit, duke marrë parasysh ponderimet e shumave të këtyre komponentëve të kapitalit. Me fjalë tjera, WACC-u është shuma e mesatares së ponderuar të kostos së ekuitetit dhe kostos së borxhit.
Për koston e ekuitetit, ZRRE-ja ndjek metodologjinë e njohur ndërkombëtare të quajtur "Modeli i Çmimit të Kapitalit të Aseteve" (CAPM). CAPM shpreh koston e pritur të ekuitetit si një normë pa rrezik (r_f) plus premiumin e rrezikut të ekuitetit (ERP). Ne mund ta definojmë ERP si ndryshimin mes rrezikut të tregut të ekuitetit – d.m.th. kthimi i pritur nga tregu i zhvilluar mirë – dhe normën e kthimit pa rrezik, e që shprehet me formulën e paraqitur më poshtë:

$$\mathbf{ERP = (r_m - r_f)}$$

Norma e ERP varet nga rreziku i investimit në një treg të një vendi të veçantë.

Vlera e WACC-ut para tatimeve mund të llogaritet sipas formulës në vijim:

$$WACC_{pre\text{-}tax} = [(D/V)*k_d] + [(E/V)*k_e]$$

ku:

D/V	Raporti i borxhit ndaj totalit të bazës së kapitalit (si përqindje)
E/V	Raporti i ekuitetit ndaj totalit të bazës së kapitalit (si përqindje)
V	Totali i bazës së kapitalit, që është shuma e ekuitetit dhe borxhit
$\mathbf{k_d}$	Kostoja e Borxhit
$\mathbf{k_e}$	Kostoja e Ekuitetit

Kostoja e borxhit (k_d) është zotim kontraktual dhe është norma interesit që ndërmarrja paguan në huatë (kreditë) aktuale.
Kostoja e ekuitetit (k_e) llogaritet si në vijim:

$$\mathbf{k_e = r_f + \beta_e *(r_m - r_f)}$$

ku:

$\mathbf{r_f}$	Norma pa rrezik dhe nxirret nga vlerësimet për kthimin në obligacionet ("bondet") e qeverisë
$\mathbf{\beta_e}$	"Beta": masa e rrezikut për kompaninë përkatëse

$(r_m - r_f)$ Premiumi i rrezikut të tregut të ekuitetit minus norma e kthimit pa rrezik

"Premiumi i rrezikut" është përcaktuar nga "beta" dhe nga premiumi i rrezikut të pritur të një tregu, e që investitorët e kërkojnë nga tregu si tërësi. Faktori "beta" matë pa-parashikueshmërinë e kthimit të një kompanie në relacion me tregun e mallrave (aksioneve) si tërësi.
Më poshtë ne vlerësojmë / llogarisim koston e borxhit dhe koston e ekuitetit për ndërmarrjet e ngrohjes qendrore në Kosovë, për të ardhur tek WACC para tatimeve.

Kostoja e Borxhit

Për këtë sezon të ngrohjes dhe sezonet vijuese, ZRRE-ja ka vendosur që raporti D/V në vlerën 60/100 (60% borxh dhe 40% ekuitet). Ky raport 60% duhet të përdoret në vlerësimet / llogaritjet e WACC-ut komercial para tatimeve për sezonin e ngrohjes 2022/2023, si dhe për sezonet vijuese, nëse nuk vërehen ndryshime domethënëse.

Aktualisht NQ Termokos ka huan nga KfW me normë interesi 8.79% për investimet në projektin e kogjenerimit. Lidhur më këtë duhet theksuar se pjesa më e madhe e investimeve të projektit të kogjenerimit ka qenë donacione (nga Qeveria Gjermane, Komisioni Evropian dhe nga Institucionet vendore qendrore dhe lokale); përderisa shuma prej 5,000,000 € është kredi nga KfW me normë interesi vjetor prej 8.97 % dhe afat kthimi 11 vjet. Rrjedhimisht kostoja e borxhit do te reflekton kredinë aktuale dhe fiksohet në vlerën **8.79 %**

Pra Kostoja e borxhit është:

$$\boxed{k_d = 8.79\ \%}$$

Kostoja e Ekuitetit

Kostoja e ekuitetit paraqitet me formulën më poshtë:

$$k_e = r_f + \beta_e * (r_m - r_f)$$

ku:
$(r_m - r_f) =$ **ERP** – Premiumi i Rrezikut në Ekuitet

Norma pa Rrezik ("Risk Free Rate - r_f) aktualisht, bazuar në trendet financiare vendore dhe ndërkombëtare të obligacioneve qeveritare (bonove të thesarit) vlerësohet në rangun prej 1.1 deri 3.0%. Kufiri i ulët përfaqëson nivelin e interesave për bonot e thesarit afatgjatë të Kosovës përderisa kufiri i lartë përfaqëson mesataren 10 vjeçare interesave nga bonot e thesarit të Hungarisë – që përfaqëson emetuesin më të rrezikshëm të borxhit të tregtuar afatgjatë në mesin e krahasuesve rajonal. Bazuar në këtë ZRRE e fikson **Normën pa Rrezik** në vlerën **2.3 %.**

Vendimet e fundit të autoriteteve rregullative e vlerësojnë premiumin e rrezikut në ekuitet në rangun prej 3.5 gjer në 5%. Për shkak se NQ Termokos është ndërmarrje publike konsiderohet se rreziku në ekuitet është minimal dhe rrjedhimisht përvetësohet që vlera e **ERP-së të jetë e barabartë me 4.5%.**

Beta mesatare e aseteve për rrjetet e energjisë elektrike në BE dhe për ndërmarrjet e integruara është 0.42 e krahasuar me 0.54 - 0.63 për ndërmarrjet që kanë vetëm gjenerimin dhe furnizimin në BE dhe SHBA. Për shkak se industria e ngrohjes qendrore ne Kosovë është e vogël, duket e arsyeshme qe të

supozojmë se rritja e kërkesës – që është faktori kryesor për rritjen e të ardhurave – do të jetë më e pa-parashikueshme se sa rritja e GDP – që është faktori kryesor për rritjen e tregut të mallrave dhe aksioneve – se sa në vendet e mëdha dhe të zhvilluara. Shtimi i një konsumatori të vetëm të madh në ngrohjen qendrore do të thotë rritjen e kërkesës për ngrohje qendrore në krahasim me kërkesën e mëparshme, përderisa ndikim në GDP mund të jetë shumë më i vogël. Në mënyrë që ta marrin në konsideratë natyrën më të pa-parashikueshme të të ardhurave të ndërmarrjeve të ngrohjes qendrore në krahasim me rritjen e GDP, ne vlerësojmë që kostoja e ekuitetit të jetë më e lartë se sa mesatarja e vendosur nga rregullatorët e BE-së, dhe ne konsiderojmë se "β_e "e arsyeshme për ndërmarrjet e ngrohjes qendrore në Kosovë të jetë **$\beta_e = 1$.**

Kostoja e ekuitetit pas tatimeve është si në vijim:

$$k_{e\ post\ tax} = 2.3\% + (1 * 4.5\ \%) = 6.80\%$$

Kostoja e ekuitetit para tatimeve gjendet duke shumëzuar rezultatin më lartë të kostos së ekuitetit pas tatimeve me relacionin që e konsideron tatimin ("tax wedge") si më poshtë:

'Tax wedge' = 1/(1-t)

ku:

t Shkalla e tatimit në fitimin e kompanive

Tatimi në fitim (t) në Kosovë është 10% dhe relacioni që e konsideron tatimin ("tax wedge") është:

1/(1-0.10)= 1.11

Kostoja e ekuitetit para tatimeve është:

$$k_{e\ pre\text{-}tax} = 6.80\% * 1.11 = 7.55\ \%$$

Si rrjedhim i llogarive më lartë llogaritet WACC-u para tatimeve – i rrumbullakuar në dy decimale – si më poshtë:

$$WACC_{pre\text{-}tax} = [8.79\% * 0.6\ ] + [7.55\% * 0.4\ ] = 8.30\%$$

<u>Llogaritja e Kthimit të Lejuar në RABf për NQ Termokos</u>

Bazuar në $WACC_{pre\text{-}tax}$ e llogaritur prej 8.30% në 3.4.1, llogaritet Kthimi i lejuar apo Profiti i lejuar për NQ Termokos, sipas formulës më poshtë:

$$RET = RoR \times RAB_f$$

Pra Kthimi i lejuar në RAB_f është i barabartë me 25,707,463 € * 8.30% = 2,132,748 €.

Tabela 4: Kthimi i Lejuar (Profiti i Lejuar) në RABf për sezonin e ngrohjes 2026/2027

	Kthimi i Lejuar (Profiti i Lejuar) në RABf për NQ TERMOKOS	Lejuar nga ZRRE [€]
RABf	Baza e Rregulluar e Aseteve - vetëfinancuar	26,707,463
RoR	Norma e Kthimit në vlerën e WACC	8.30%
	Kthimi i Lejuar ose Profiti i Lejuar	**2,215,710**

3.5 Përcaktimi i Kostos së Humbjeve në Rrjet

Kostoja e lejuar e humbjeve të rrjetit shërben për të mbuluar kostot që i shkaktohen ndërmarrjes për shkak të humbjeve të energjisë termike gjatë transportit dhe shpërndarjes. Në përputhje me Shtojcën 1 të Rregullës për Vendosjen e Çmimeve të Energjisë Termike kjo kosto llogaritet si herësi në mes të humbjeve sasiore të rrjetit dhe prodhimit të energjisë termike që hyn në rrjet (niveli në përqindje i humbjeve të tërësishme në rrjet), kjo e shumëzuar me koston e përgjithshme variabile të prodhimit.
Nga sa u tha më lartë, bazuar në dhënat e paraqitura nga NQ Termokos dhe në vlerësimet e veta, ZRRE ka zhvilluar Bilancin e energjisë termike të NQ Termokos për sezonin 2026/2027, përmes së cilit ka përcaktuar humbjet sasiore të rrjetit **31,562 MWh** – që është shuma e humbjeve sasiore në rrjetin e transportit TC Kosova B – NQ Termokos (7,447 MWh) dhe humbjeve sasiore në rrjetin e shpërndarjes (24,115 MWh). Shprehur në përqindje, niveli i përgjithshëm i humbjeve në rrjet është 8.62% - niveli i humbjeve në rrjetin e transportit: 2.0% dhe niveli i humbjeve në rrjetin e shpërndarjes 6.62%. Gjithashtu nga Bilanci i energjisë termike është derivuar sasia e prodhimit (gjenerimit) neto dhe blerjeve neto të energjisë termike – në sasi totale 372,359 MWh.

Bazuar në vlerat më lartë dhe në koston variabile operative (4,195,074 €) llogaritet **Kostoja e humbjeve** në rrjet në vlerën **363,476 €.**

3.6 Përshtatja (Axhustimi)

Përshtatja (axhustimi) shërben për të korrigjuar ndryshimet eventuale mes planifikimeve të shqyrtimit tarifor për periudhën (sezonin) 'n-1' dhe realizimeve që faktikisht kanë ndodhur në atë periudhë (sezon) dhe ato ndryshime përfshihen (korrigjohen) në shqyrtimin e ardhshëm. Ndryshimet mes planifikimeve dhe realizimeve për periudhën (sezonin e kaluar 2025/'26) janë konstatuar përmes Raportit të monitorimit të realizimeve për këtë sezonë.

Konkretisht axhustimi përfshinë ndryshimin mes planifikimit dhe realizimit faktik të këtyre komponentëve: i) Të hyrave; Kostove Operative; Zhvlerësimit vjetorë; dhe kthimit në RAB_f.

Vlera totale e axhustimit për sezonin paraprak 2025/26 është llogaritur: **178,829 €.** Pra kjo vlerë i shtohet vlerës së të Hyrave të lejuara për sezonin 2026/2027.

3.7 Llogaritja e të Hyrave Maksimale të Lejuara - Përmbledhje

Të hyrat e lejuara totale janë llogaritur sipas formulës:

MAR = OC + DEP + RTN + LOS +/- ADJ

Fillimisht duhet theksuar se në llogaritjen e të Hyrave maksimale të lejuara merren Kostot operative të zbritura për koston e lejuar të humbjeve (kostot operative të ashtuquajtura neto në vlerë prej **7,336,676€.**

Rrjedhimisht vlera e MAR është e barabartë me **12,468,107 €** siç paraqitet detajisht në tabelën 5.

Tabela 5: Të Hyrat e lejuara për NQ Termokos sezoni i ngrohjes 2026/2027

Të Hyrat e Lejuara NQ TERMOKOS për sezonin 2026/2027		Lejuar nga ZRRE [€]
OC	Kostot Operacionale të Lejuara (neto)	7,336,676 €
DEP	Zhvlerësimi Vjetor	2,373,415 €
RTN	Kthimi i Lejuar në RAB_f	2,215,710 €
LOS	Kostot e lejuara te humbjeve	363,476 €
ADJ	Axhustimi – ndryshimi mes lejimeve dhe realizimeve	178,829 €
MAR	**Të Hyrat Maksimale të Lejuara**	**12,468,107 €**

Për të qenë në përputhshmëri me strukturën tarifore, që parasheh ndarjen në komponentën për kapacitetin termik (komponenti fiks) dhe në komponentën e sasisë së energjisë termike (komponenti variabil), ndarja e MAR-it bëhet sipas proporcionit: pjesa fikse 15% dhe pjesa variabile 85%. Rrjedhimisht ndarja e MAR-it në pjesën fikse dhe variabile për sezonin e ngrohjes 2026/2027 është si vijon:

Pjesa fikse e të Hyrave Maksimale të Lejuara (MAR_F) **1,870,216 €**; dhe
Pjesa variabile e të Hyrave të Lejuara (MARv) **10,597,891 €.**

4. Bilanci i Energjisë Termike

Bilanci i energjisë termike është një komponentë mjaft e rëndësishme në shqyrtimin tarifor sepse përcaktohen projeksionet për prodhimin/blerjet e energjisë termike, humbjet në rrjet dhe përfundimisht furnizimin e konsumatorëve. Për këtë arsye projeksionet në Bilanc janë me ndikim në planifikimin e kostove respektive, dhe rrjedhimisht me ndikim në përcaktimin e të Hyrave të lejuara dhe tarifave.
Në vijim në forma tabelare dhe grafike janë paraqitur të përmbledhur komponentët e Bilancit të energjisë termike për NQ Termokos për shqyrtimin tarifor të sezonit 2026/2027.

Tabela 6: Përmbledhje e Bilancit të energjisë termike

Balanca e Energjise Termike - NQ Termokos sez. 2026/2027		Propozuar nga NQ Termokos	Lejuar nga ZRRE [€]
Bruto Prodhimi i En. Term. Në Ngrohtore	MWh	43	41
Bruto Blerjet e En. Term. (Hyrja në Rrjet. Transp.)	MWh	402,913	372,359
Neto Blerjet e En. Term. (Dalja nga Rrjet. Transp.)	**MWh**	**394,855**	**364,912**
Humbjet sasiore në Rrjetin e Transportit	MWh	8,058	7,447
Humbjet në përqindje në Rrjetin e Transportit	%	2.00%	2.00%
Bruto Prodhimi + Bruto Blerjet e En. Term.	**MWh**	**402,956**	**372,400**
Humbjet sasiore në Rrjet. Transp. + Konsumi vetanak	MWh	8,738	8,127
Neto Prodhimi + Neto Blerjet e En. Term. (Hyrja në Rrjet. Shpërnd.)	**MWh**	**394,218**	**364,273**
Humbjet në Rrjetin e Shpërndarjes	MWh	26,097	24,115
Humbjet në përqindje në Rrjetin e Shpërndarjes	%	6.62%	6.62%
Furnizimi / Konsumi i En. Term.	**MWh**	**368,121**	**340,158**